



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.528/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtares, Florije Zatriqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Noci, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurit, N. B nga fsh. G K. Pejë për shkak të veprës penale *legalizim i përmbajtës së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së*, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.394/2016 të dt.14.06.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.27.03.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Lumturije Vuçetaj dhe të pandehurit N B, me dt.27.03.2017, morri, publikisht shpalli dhe me dt. 05.04.2017 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri N B lindur më, në fsh. G K. Pejë, i biri i D dhe i L e gjinisë Z, ka të kryer shkollën, i gjendjes së ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, lëshuar nga MPB R. e Kosovës, i nacionalitetit serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se

Me dt. 11.04.2012, në kohë të pacaktuar, në QRA-Pejë, vë në lajthim organin kompetent që të vërtetoj një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri N B pasi merr dokumentin e falsifikuar të shteti i Serbisë, me numër CP05940947 dhe shkon në QRA –Pejë, të cilët i vë në lajthim që ta regjistrojnë veturën Volkswagen Polo 1.4 ngjyrë e gjelbërt e mbyllt viti i prodhimit 1995 me numër të karrocërisë WWZZZ6NZTW030219 dhe i merr targat,

- me çka ka kryer veprën penale, *legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së*.

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 7, 8 par.1, 9, 10 par.1, 17 par, 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42, par.1 nën par. 1.1 dhe 50, 51 par.1 dhe 4, 73, 74, dhe neni 403 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par.1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450, të pandehurit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që ndaj të pandehurit, i përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **tre (3) muajve**, i cili dënim fare nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej **një (1) viti**, nuk do të kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri, obligohet që gjykatës ti paguaj paushallin gjyqësor, shumën prej **njëzetë (20) euro**, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II.nr.394/2016 të dt.14.06.2016, kundër të pandehurit N. B, për shkak të veprës penale, *legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së*.

Gjykata ka mbajtur seancën fillestare me datën 27.03.2017, në prezencë të prokurorit të shtetit, dhe të pandehurit, i njëjti u njoftua me të drejtat e tija, u njoftua me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë dhe mendimit të prokurorit i cili nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 par.4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit N. B, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, *legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së*.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se, tek i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, e për më tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. I pandehuri asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar nga gjykata dhe se ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale. Andaj, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të pandehurit. Si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK -së, të pandehurin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është bindur se vendimi mbi dënimin, do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor shumë prej njëzetë (20) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar gjatë kësaj procedure penale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 332 par.3 të KPK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË –DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.528/16

Sekretarja juridike

Gj y q t a r j a

Bute Noci

Floriqe Zatriqi

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.